

NR. 5153
24.05.2018



SHOQËRIA "F.K. APOLLONIA" SHA
NIPT: K23326401F
ADRESA E SELISË: L. "16 PRILLI", FIER

VENDIM NR.1
DATE 24/05/2018
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË "F.K. APOLLONIA"SHA

Sot, më datë 24/05/2018, ora 10:00, në selinë e shoqërisë "F.K. Apollonia"sha, në adresën: Lagja "16 Prilli", Fier, mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë "F.K. Apollonia"sha, për të diskutuar në lidhje me çështjet e rendit të ditës si më poshtë vijon:

1. Zmadhim kapitali në para me kontribut të aksionarit "Bashkia Fier";
2. Të tjera sipas propozimeve.

Të pranishëm në këtë mbledhje janë të gjithë aksionarët dhe konkretisht:

- Aksionari, shoqëria "2K Group"shpk, përfaqësuar nga Administratorja Znj. Enkeleda Pura;
- Aksionari, Bashkia Fier, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Armando Subashi.

Në bazë të nenit 144 dhe 145 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, aksionarët e shoqërisë unanimisht,

VENDOSËN:

1. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë "F.K. Apollonia"sha në shumën prej 10,000,000 (dhjetë milionë) Lekë, duke nënshkruar 10,000 (dhjetëmijë) aksione të reja me vlerë nominale 1,000(njëmijë) Lekë për aksion, të cilat do të shlyhen vetëm nga aksionari Bashkia Fier, duke respektuar dispozitat ligjore tregtare në fuqi në lidhje me shlyerjen e kontributit në para.
2. Aksionet do të shlyhen nga Aksionari Bashkia Fier, brenda Vitit 2018.
3. Pas realizimit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë në shumën 10,000,000 (dhjetë milionë) Lekë, kapitali i shoqërisë nga 557,200,000 (pesëqindë e pesëdhjetë e shtatë milionë e dyqind mijë)Lekë që ishte para zmadhimit, do të shkojë në shumën 567,200,000(pesëqindë e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e dyqind mijë) Lekë, i ndarë në



567,200 (pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqindë) aksione, i zotëruar nga aksionarët si më poshtë:


- Aksionari, shoqëria “2K Group” shpk do të zotërojë 339,450 (treqindë e tridhjetë e nëntë mijë e katërqindë e pesëdhjetë) aksione me vlerë nominale 1,000 (njëmijë) Lekë secili, të cilat zënë një pjesëmarrje prej 59,85% (pesëdhjetë e nëntë presje tetëdhjetë e pesë për qindë) në kapitalin e shoqërisë;
- Aksionari, Bashkia Fier, do të zotërojë 227,750 (dyqindë e njëzetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) aksione me vlerë nominale 1,000 (njëmijë) Lekë secili, të cilat zënë një pjesëmarrje prej 40,15% (dyzetë presje pesëmbëdhjetë për qindë) në kapitalin e shoqërisë.

ASAMBLEJA E PËRGGJITHSHME E AKSIONARËVE

Shoqëria “2K Group” shpk

Përfaqësuar nga Administratorja


Enkeleda PURA



Bashkia Fier

Përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë

Armando SUBASHI



NR-5153/2
24.05.2018



SHOQËRIA "F.K. APOLLONIA"SHA
NIPT: K23326401F
ADRESA E SELISË: L. "16 PRILLI", FIER

PROCESVERBAL I MBLEDHJES
SË ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË "F.K. APOLLONIA"SHA

Sot, më datë 24/05/2018, ora 10:00, në selinë e shoqërisë "F.K. Apollonia"sha, në adresën L. "16 Prilli", Fier, mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë "F.K. Apollonia"sha, për të diskutuar në lidhje me çështjet e rendit të ditës si më poshtë vijon:

1. *Zmadhim kapitali në para me kontribut të aksionarit Bashkia Fier;*
2. *Të tjera sipas propozimeve.*

Të pranishëm në këtë mbledhje janë të gjithë aksionarët dhe konkretisht:

- Aksionari, shoqëria "2K Group"shpk, përfaqësuar nga Administratorja Znj. Enkeleda Pura;
- Aksionari, Bashkia Fier, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Armando Subashi.

Në bazë të nenit 144 dhe 145 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.

Kryetare e mbledhjes caktohet Znj.Enkeleda Pura, përfaqësuese e aksionarit "2K Group"shpk, dhe mbajtës i procesverbalit caktohet Z. Marinel Laci.

Z. Enkeleda Pura hap mbledhjen duke falenderuar si fillim të pranishmit. Ajo shprehet se jemi mbledhur për të diskutuar për zmadhimin e kapitalit në para me kontributin e Bashkisë Fier.

E merr fjalën përfaqësuesi i Bashkisë Fier, Z. Armando Subashi, i cili shprehet se në bazë të Vendimit nr. 97, datë 19.12.2017, të Këshillit të Bashkisë Fier, është vendosur që shuma prej 10,000,000(dhjetë milionë)Lekë të destinohet për shoqërinë "F.K.Apollonia"sha, si rrjedhojë propozoj që:



1. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë "F.K. Apollonia"sha në shumën prej 10,000,000 (dhjetë milionë) Lekë, duke nënshkruar 10,000 (dhjetëmijë) aksione të reja me vlerë nominale 1,000(njëmijë) Lekë për aksion, të cilat do të shlyhen vetëm nga aksionari Bashkia Fier, duke respektuar dispozitat ligjore tregtare në fuqi në lidhje me shlyerjen e kontributit në para.
2. Aksionet do të shlyhen nga Aksionari Bashkia Fier, brenda vitit 2018.
3. Pas realizimit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë në shumën 10,000,000 (dhjetë milionë) Lekë, kapitali i shoqërisë nga 557,200,000(pesëqindë e pesëdhjetë e shtatë milionë e dyqind mijë)Lekë që ishte para zmadhimit, do të shkojë në shumën 567,200,000(pesëqindë e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e dyqind mijë)Lekë, i ndarë në 567,200 (pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatëmijë e dyqindë) aksione, i zotëruar nga aksionarët si më poshtë:
 - Aksionari, shoqëria "2K Group" shpk do të zotërojë 339,450(treqindë e tridhjetë e nëntë mijë e katërqindë e pesëdhjetë) aksione me vlerë nominale 1,000(njëmijë) Lekë secili, të cilat zënë një pjesëmarrje prej 59,85%(pesëdhjetë e nëntë presje tetëdhjetë e pesë përqindë) në kapitalin e shoqërisë;
 - Aksionari, Bashkia Fier, do të zotërojë 227,750(dyqindë e njëzetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) aksione me vlerë nominale 1,000(njëmijë) Lekë secili, të cilat zënë një pjesëmarrje prej 40,15% (dyzetë presje pesëmbëdhjetë përqind) në kapitalin e shoqërisë.

E merr fjalën Kryetarja e mbledhjes, e cila hedh në votim propozimin e lartpërmendur. Kalohet në fazën e votimit të propozimit.

Miratohet unanimisht:

1. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë "F.K. Apollonia"sha në shumën prej 10,000,000 (dhjetë milionë) Lekë, duke nënshkruar 10,000 (dhjetëmijë) aksione të reja me vlerë nominale 1,000(njëmijë) Lekë për aksion, të cilat do të shlyhen vetëm nga aksionari Bashkia Fier, duke respektuar dispozitat ligjore tregtare në fuqi në lidhje me shlyerjen e kontributit në para.
2. Aksionet do të shlyhen nga Aksionari Bashkia Fier, brenda vitit 2018.
4. Pas realizimit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë në shumën 10,000,000 (dhjetë milionë) Lekë, kapitali i shoqërisë nga 557,200,000(pesëqindë e pesëdhjetë e shtatë milionë e dyqind mijë)Lekë që ishte para zmadhimit, do të shkojë në shumën 567,200,000(pesëqindë e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e dyqind mijë)Lekë, i ndarë në 567,200 (pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatëmijë e dyqindë) aksione, i zotëruar nga aksionarët si më poshtë:
 - Aksionari, shoqëria "2K Group" shpk do të zotërojë 339,450(treqindë e tridhjetë e nëntë mijë e katërqindë e pesëdhjetë) aksione me vlerë nominale 1,000(njëmijë) Lekë secili, të cilat zënë një pjesëmarrje prej 59,85%(pesëdhjetë e nëntë presje tetëdhjetë e pesë përqindë) në kapitalin e shoqërisë;


- Aksionari, Bashkia Fier, do të zotërojë 227,750 (dyqindë e njëzetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) aksione me vlerë nominale 1,000 (njëmijë) Lekë secili, të cilat zënë një pjesëmarrje prej 40,15% (dyzetë presje pesëmbëdhjetë përqind) në kapitalin e shoqërisë.

E merr fjalën Kryetarja e mbledhjes, e cila pyet nëse ka çështje të tjera për të diskutuar. Aksionarët shprehen se nuk kanë. Meqënëse nuk ka më propozime dhe diskutime të tjera, kalohet në nënshkrimin e procesverbalit dhe marrjen e vendimeve. Me kaq mbledhja deklarohet e mbyllur. Bashkëlidhur është evidenca e pjesëmarrësve.

Procesverbali nënshkruhet nga:

Kryetare


Enkeleda Pura





Procesverbali mbahet nga:

Marinel Laci







NR. 5153/1
24.05.2018



**EVIDENCA E PJESËMARRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË
PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE DATË 24.05.2018,
TË SHOQËRISË "F.K. APOLLONIA"SHA**


Sot, më datë 24.05.2018, ora 10:00, në selinë e shoqërisë "F.K. Apollonia" sha, në adresën L. "16 Prilli", Fier, mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë "F.K. Apollonia" sha për të diskutuar në lidhje me çështjet e rendit të ditës si më poshtë vijon:

1. Zmadhim kapitali në para me kontribut të aksionarit "Bashkia Fier";
2. Të tjera sipas propozimeve.

Të pranishëm në këtë mbledhje janë të dy aksionarët që formojnë 100%(njëqindë përqind) të pjesëmarrjes.

Shoqëria "2K Group" shpk, me seli në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Pallati Abissnet, kati 2, Tiranë, përfaqësuar nga Administratorja, Znj. Enkeleda Pura

Enkeleda Pura



Bashkia Fier, me adresë: Lagjja "Kastriot", Rruga "Ramiz Aranitasi", Nr.15, Fier, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Armando Subashi

Armando Subashi



Mbajtës i Procesverbalit

Marinel Laci

Marinel Laci



SHOQËRIA "2K GROUP" SHPK

NIPT: J82221005L

ADRESA E SELISË: RRUGA "ISMAIL QEMALI",

PLL. ABISSNET, K.2, TIRANË

VENDIM NR.6

DATË 01/10/2019

I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "2K GROUP" SHPK

Sot, më datë 01/10/2019, ora 11:00, në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Pallati Abissnet, Kati 2, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "2K Group" shpk, për të vendosur në lidhje me rendin e ditës si më poshtë vijon:

1. Zgjidhja në mënyrë të vullnetshme e Kontratës së Shitjes së Aksioneve Nr.11390 Rep., Nr. 2030 Kol., datë 20.09.2013, lidhur ndërmjet shoqërisë "2K Group" shpk, në cilësinë e Blerësit dhe Z. Koço Kokëdhima, në cilësinë e Shitësit;
2. Autorizimi i Administratores së shoqërisë "2K Group" shpk, Znj. Brixhilda Kokëdhima, që të nënshkruajë Akt Marrëveshjen për zgjidhjen e Kontratës së Shitjes së Aksioneve Nr. 11390 Rep., Nr. 2030 Kol., datë 20.09.2013, lidhur ndërmjet shoqërisë "2K Group" shpk, në cilësinë e Blerësit dhe Z. Koço Kokëdhima, në cilësinë e Shitësit;
3. Të ndryshme.

Në këtë mbledhje janë të pranishëm personalisht të gjithë ortakët e shoqërisë dhe konkretisht:

- Znj. Brixhilda Kokëdhima, e cila zotëron 35.00% të kuotave të kapitalit të shoqërisë;
- Znj. Herjeta Deliaj, e cila zotëron 30.00% të kuotave të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Koço Kokëdhima, i cili zotëron 35.00% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Pas nënshkrimit të Akt Marrëveshjes për Zgjidhjen e Kontratës së Shitjes së Aksioneve Nr.11390 Rep., Nr. 2030 Kol., datë 20.09.2013, aksionarët e shoqërisë "FK Apollonia" sha, do të jenë:

- a. Bashkia Fier zotëruese e 36,78% të kapitalit, në shumën 227,750,000 Lekë që përkon me 227,750 aksione;
- b. 2K Group shpk zotëruese e 0,68% të kapitalit, në shumën 4,200,000 Lekë që përkon me 4,200 aksione;

- c. Shoqëria Sirius sha zotërues i 8,40% të kapitalit, në shumën 52,000,000 Lekë që përkon me 52,000 aksione
- d. Koço Kokëdhima zotërues i 54,14% të kapitalit, në shumën 335,250,000 Lekë që përkon me 335,250 aksione.

Meqënëse në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë ortakët e shoqërisë dhe kuorumi i nevojshëm për marrjen e vendimeve të vlefshme, Znj. Brixhilda Kokëdhima, në cilësinë e Kryetares së mbledhjes, e deklaroi Asamblenë e Ortakëve të mbledhur rregullisht dhe të hapur. Pas shqyrtimit me vëmendje të çështjeve të rendit të ditës, ortakët ranë dakord për sa më sipër në mënyrë unanime dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë,

VENDOSËN:

1. Të zgjidhin në mënyrë të vullnetshme Kontratën e Shitjes së Aksioneve Nr. 11390 Rep., Nr. 2030 Kol., datë 20.09.2013, lidhur ndërmjet shoqërisë "2K Group" shpk, në cilësinë e Blerësit dhe Z. Koço Kokëdhima, në cilësinë e Shitësit. Pas zgjidhjes së kësaj kontrate, aksionarët e shoqërisë "FK Apollonia" sha do të jenë:
 - a. Bashkia Fier zotëruese e 36,78% të kapitalit, në shumën 227,750,000 Lekë që përkon me 227,750 aksione;
 - b. 2K Group shpk zotëruese e 0,68% të kapitalit, në shumën 4,200,000 Lekë që përkon me 4,200 aksione;
 - c. Shoqëria Sirius sha zotërues i 8,40% të kapitalit, në shumën 52,000,000 Lekë që përkon me 52,000 aksione
 - d. Koço Kokëdhima zotërues i 54,14% të kapitalit, në shumën 335,250,000 Lekë që përkon me 335,250 aksione.

2. Të autorizojnë Administratoren e shoqërisë "2K Group" shpk, Znj. Brixhilda Kokëdhima, që të nënshkruajë Akt Marrëveshjen për zgjidhjen e Kontratës së Shitjes së Aksioneve Nr. 11390 Rep., Nr. 2030 Kol., datë 20.09.2013, lidhur ndërmjet shoqërisë "2K Group" shpk, në cilësinë e Blerësit dhe Z. Koço Kokëdhima, në cilësinë e Shitësit.

Pasi nuk pati çështje të tjera për të diskutuar, Kryetarja e mbledhjes, e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

Brixhilda KOKËDHIMA

Herjeta DELIAJ

Koço KOKËDHIMA

Brixhilda Kokëdhima
[Signature]



Herjeta Deliaj
[Signature]

Koço Kokëdhima
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË


NR. _____ .REP

NR. _____ .KOL

7172

2064

Majlinda E. Demollari
Taksa e Pulës
U Paqya



AKT MARRËVESHJE

PËR ZGJIDHJEN E KONTRATËS SË SHITBLERJES SË AKSIONEVE
DATË NR. 11930 REP, NR. 2030 KOL, 20.09.2013

Në Tiranë, sot, më datë 10/10/2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), para meje Noteres Majlinda E. Demollari, me seli ne adresën: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Vaso Pasha", Pallati nr.10, Shk nr.1, Ap nr.3, Tiranë, u paraqitën personalisht palët si më poshtë:

Shoqëria "2K Group" shpk, përfaqësuar për nënshkrimin e kësaj akt marrëveshje nga Administratorja Brixhilda Kokëdhima, në bazë të vendimit nr. 6, dt. 01.10.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve (në vijim të kësaj kontrate do të quhet **Pala e Parë** ose Shoqëria "2K Group" shpk);

Dhe,

Koço KOKËDHIMA, i biri i Theodhori-ut, lindur ne Qeparo Vlorë, më 21.04.1959, banues në Rr. Ismail Qemali, Pallati 18, Tiranë, Shqipëri, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi me nr. 028976599, që në vijim të kësaj kontrate do të quhet **Pala e Dytë**;

Hyrje

- A.** Shoqëria "F.K Apollonia" sha, është nje shoqëri aksionare e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: K23326401F. Kjo shoqëri ka për objekt të veprimtarisë kryerjen e administrimit të aktivitetit të skuadrës së futbollit "Apollonia".
- B.** Me anë të Kontratës së Shitblerjes së aksioneve Nr. 11930 Rep, nr. 2030 kol, datë 20.09.2013, Pala e Dytë i ka shitur Palës së Parë 335,250 (treqindë e tridhjetë e pesë mijë e dyqindë e pesëdhjetë) aksione, që përfaqësonin 72,33% (shtatëdhjetë e

dy presje tridhjetë e tre përqind) të kapitalit të shoqërisë “F.K Apollonia”sha, kundrejt çmimit 335,250,000 (treqindë e tridhjetë e pesë milion e dyqindë e pesëdhjetë mijë) Lekë. Prej këtij çmimi, Pala e Parë i ka likujduar Palës së Dytë, pjesën e çmimit prej 3,000,000 (tre milion) Lekë.

- C. Shoqëria “2K Group”shpk, gjatë vitit 2016, në përputhje me dispozitat ligjore tregtare ka realizuar emetimin e 4,200 (katërmijë e dyqindë) aksioneve të reja, me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lekë për çdo aksion, duke u rritur kapitali i aksionerit “2K Group” shpk tek “FK Apollonia”sha, me 4,200,000 (katër milion e dyqindëmijë) Lekë. Pas kësaj, kapitali i shoqërisë “2K Group”shpk tek “F.K Apollonia”sha është bërë 339,450,000 (treqindë e tridhjetë e nëntë milion e katërqindë e pesëdhjetë mijë) Lekë, i ndarë në 339,450 (treqindë e tridhjetë e nëntë mijë e katërqindë e pesëdhjetë) aksione, me vlerë nominale 1,000 (njëmijë) Lekë çdo aksion.
- D. Aktualisht, kapitali total i shoqërisë “FK Apollonia” sha është 619,200,000 Lekë (gjashtëqindë e nëntëmbëdhjetë milion e dyqindë mijë) Lekë, i ndarë në 619,200 (gjashtëqindë e nëntëmbëdhjetëmijë e dyqindë) aksione, nga të cilat 339,450 aksione janë në pronësi të aksionarit 2K Group shpk, 227,750 aksione janë në pronësi të aksionarit Bashkia Fier dhe 52,000 aksione janë në pronësi të aksionarit Sirius sha.
- Ç. Duke qenë se Pala e Parë, shoqëria “2K Group”shpk, ka likujduar pjesën e çmimit prej 3,000,000 (tre milion) Lekë, por, nuk ka likujduar pjesën tjetër të çmimit, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, bazuar në nenin 737 të Kodit Civil, palët e mësipërme bien dakord për përpilimin e kësaj akt marrëveshje për zgjidhjen e kontratës së shitblerjes së aksioneve Nr. 11930 Rep, nr. 2030 kol, datë 20.09.2013.

Neni 1

Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj Akt Marrëveshjeje është zgjidhja në mënyrë të vullnetshme e Kontratës së Shitblerjes së Aksioneve Nr. 11930 Rep, nr. 2030 kol, datë 20.09.2013 lidhur ndërmjet Palës së Parë në cilësinë e Blerësit dhe Palës së Dytë në cilësinë e Shitësit, dhe kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme.

Neni 2

Kthimi në gjendjen e mëparshme

- 2.1 Me nënshkrimin e kësaj Akt Marrëveshjeje, Pala e Parë i kthen Palës së Dytë të drejtën e pronësisë mbi 335,250 (treqindë e tridhjetë e pesë mijë e dyqindë e pesëdhjetë) aksioneve në shoqërinë "F.K Apollonia"sha, të cilat aktualisht përfaqësojnë 54,14 % (pesëdhjetë e katër presje katërmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "F.K Apollonia"sha.
- 2.2 Pala e Dytë do t'i kthejë Palës së Parë pjesën e çmimit të paguar prej Palës së Parë në shumën 3,000,000 (tre milion) Lekë.
- 2.3 Shoqëria "2K Group"shpk do të ruajë të drejtën e pronësisë mbi 4,200 (katërmijë e dyqind) aksionet e emetuara, nënshkruara dhe paguara gjatë vitit 2016, të cilat, përfaqësojnë 0,68% (zero presje gjashtedhjetë e tetë përqind) të kapitalit të kësaj shoqërie.
- 2.4 Me nënshkrimin e kësaj akt marrëveshjeje, aksionarë të shoqërisë FK Apollonia janë subjektet e mëposhtëm:
- Bashkia Fier zotëruese e 36,78% të kapitalit, në shumën 227,750,000 Lekë që përkon me 227,750 aksione;
 - 2K Group shpk zotëruese e 0,68% të kapitalit, në shumën 4,200,000 Lekë që përkon me 4,200 aksione;
 - Shoqëria Sirius sha zotëruese e 8,40% të kapitalit, në shumën 52,000,000 Lekë që përkon me 52,000 aksione;
 - Koço Kokëdhima zotërues i 54,14% të kapitalit, në shumën 335,250,000 Lekë që përkon me 335,250 aksione.
- 2.5 Me nënshkrimin e kësaj Akt Marrëveshjeje, palët deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim tjetër ndërmjet tyre.
- 2.6 Pala e Dytë deklaron se njeh dhe pranon fuqinë e të gjithë vendimeve të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve të miratuara nga data e Kontratës së Shitblerjes së Aksioneve Nr. 11930 Rep, nr. 2030 kol, datë 20.09.2013 deri në datën e nënshkrimit të kësaj akt marrëveshjeje për zgjidhjen e kontratës së shitblerjes së lartpërmendur.



Neni 3

Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit

3.1 Kjo akt marrëveshje do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Të ndryshme

- 4.1 Ligji i zbatuar: Kjo Akt Marrëveshje bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.2 Mosmarrëveshjet: Çdo mosmarrëveshje që mund të krijohet nga kjo Akt Marrëveshjeje, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 4.3 Gjuha e Akt Marrëveshjes: Kjo Akt Marrëveshje është hartuar në 3 ekzemplarë origjinalë në gjuhën Shqipe, në kopje për Palën e Parë, një kopje për Palën e Dytë, dhe një kopje do të mbahet nga unë noterja.
- 4.4 Dokumentet bashkëlidhur: 1. Vendimi nr.6, dt. 01.10.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “2K Group”shpk; 2. Kopje e kontratës së shitblerjes së aksioneve Nr. 11930 Rep, nr. 2030 kol, datë 20.09.2013; 3. Ekstrakt historik i shoqërisë “FK Apollonia”sha dhe Ekstrakt i shoqërisë “2K Group”shpk.

Kjo Akt Marrëveshje i lexohet Palëve me zë të lartë, të cilat pasi e kuptojnë, e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe e firmosin atë përpara meje Noteres Majlinda E. Demollari, dhe unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

PALËT

PALA E PARË

Shoqëria “2K Group”shpk përfaqësuar nga Administratorja Brixhilda KOKËDHIMA në bazë të vendimit nr. 6, dt.01.10.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

Brixhilda Kokëdhima

PALA E DYTË
KOÇO KOKËDHIMA



NOTERE

NOTERE
Majlinda E. Demollari
NIP: 2414060904
Tel: 0682061560


372
15.10.2013

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 1193 REP

NR. J.030 KOL

KONTRATË SHITJE AKSIONESH



Sot me datë 20/10/2013, përpara meje noteres Majlinda Demollari, me seli në Rr "Vaso Pasha", Tiranë, u paraqitën palët e mëposhtëme:

- I. **KOÇO KOKËDHIMA**, i biri i Theodhoriut, lindur në Qeparo, Vlorë, më 21.04.1959 dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Ismail Qemali", Pallati "Abissnet", madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letënjoftimin me nr.028976599, referuar më poshtë "shitësi"

Shoqëria "2K Group" shpk, regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendim e Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë nr.19653, datë 22.06.1998, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të

- II. Regjistrimit me Nipt- J82221005L, me seli në adresën Rr. "Ismail Qemali", pall. "Abissnet", kati i II-të, Tiranë, ligjërish e përfaqësuar nga Administratorja Brixhilda Kokëdhima, identifikuar me letërjoftimin me nr.028976599, e cila, këtu e në vijim do të referohet si "blerësi"

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- A. Shitësi zotëron 335,250(treqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë) aksione në kapitalin e shoqërisë "F.K. Apollonia" sha që përbëjnë 72,33 % të kapitalit të shoqërisë.
- B. Blerësi është i interesuar që të blejë dhe shitësi është i interesuar që të shesë të gjitha aksionet që zotëron në kapitalin e shoqërisë "FK Apollonia" sha duke u larguar si aksionar nga kjo shoqëri.
- C. Në përputhje me nenin 117 "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve" pika b, nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe meqënëse në bazë të statutit të shoqërisë aksionari tjetër është njoftuar por ka kthyer përgjigje se nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes për aksionet e shitësit, hartohet kontrata e shitjes së aksioneve me kushtet si më poshtë vijon:

Atëherë, palët bien dakord për kushtet e kontratës si më poshtë vijon:

**NENI 1
OBJEKTI**

- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është shitja e 335,250 (treqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë) aksioneve, me vlerë nominale 1000(njëmijë) lekë për çdo aksion. Këto aksione transferohen nga Shitësi në pronësi të Blerësit.
- 1.2 Me blerjen e aksioneve, blerësi bëhet aksionar i shoqërisë duke zotëruar të gjitha të drejtat e plotë mbi aksionet dhe shitësi heq dorë përfundimisht prej tyre duke u larguar si aksionar i shoqërisë.

**NENI 2
ÇMIMI**

- 2.1 Aksionet do t'i shiten blerësit kundrejt vlerës së tyre nominale, në shumën 335,250,000 (treqind e tridhjetë e pesë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
- 2.2 Vlera e mësipërme do t'i likujdohet shitësit nga blerësi jashtë kësaj zyre noteriale në një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

**NENI 3
KALIMI I PRONËSISË MBI AKSIONET**


- 3.1 Blerësi do të bëhet zotëruar me të drejta të plota i 335,250 aksioneve në kapitalin e shoqërisë "F.K. Apollonia" sh.a. menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët dhe Shitësi heq dorë përfundimisht nga çdo pretendim, të drejta apo detyrime lidhur me këto aksione.

**NENI 4
GARANCITË**

- 4.1 Shitësi garanton Blerësin se aksionet janë krejtësisht të lira nga çdo peng dhe barrë.
- 4.2 Blerësi do të bëhet zotëruar me të drejta të plota i 335,250 aksioneve në kapitalin e shoqërisë "F.K. Apollonia" sha, me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe shlyerjen e plotë të çmimit të shitjes dhe Pala e Parë do të heqë dorë nga çdo pretendim, të drejta apo detyrime lidhur me këto aksione.

**NENI 5
REGJISTRIMI**

- 5.1 Shitësi dhe Blerësi pranojnë t'i japin njëri-tjetrit me kërkesë të palës tjetër dhe/ose Shoqërisë çdo dokument të nevojshëm për të transferuar pjesët e kapitalit që janë objekt i kësaj kontrate dhe për ta regjistruar këtë transferim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në bazë të nenit 119 pika 5 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » dhe nenit 43 pika 4 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".



NENI 6
LIGJI I ZBATUESHËM

- 6.1 Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe çdo interpretim në lidhje me sa është shprehur më sipër, apo çdo paqartësi përsa i përket interpretimit do të bëhet në përputhje të plotë me këto ligje.
- 6.2 Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë kontratë, gjejnë zbatim dispozitat ligjore të parashikuara në pikën 6.1.

Neni 7
JURIDIKSIONI

- 7.1 Në rast të mosmarrëveshjeve që nuk zgjidhen me mirëkuptim mes Palëve, juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Neni 8
TË NDRYSHME

- 8.1 Kushtet e përgjithshme janë pjesë e pandarë e kësaj kontrate.
- 8.2 Çdo ndryshim apo amendim në lidhje me kushtet e mësipërme dhe pranuar nga Palët apo çdo shtim i ndonjë kushti tjetër lidhur me qëllimin e kësaj kontrate mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të dyja palëve duke respektuar formën shkresore të noterizuar.

Kjo kontratë u përpilua në 4 (katër) kopje me vlerë të njëjtë ligjore, nga një për t'u mbajtur nga Palët, një e mban noterja dhe një për t'u dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Kontrata pasi i'u lexua palëve me zë të lartë, u pranua prej tyre pasi u gjet në përputhje me vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve, nënshkruhet në mënyrë të rregullt prej tyre, para meje, dhe unë noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

SHITËSI
KOÇO KOKËDHIMA

PALA E DYTË
SHOQËRIA "2K GROUP" SHPK
Administratore
Brixhilda KOKËDHIMA

NOTER

Maria... Dompallant
74...



VENDIM NR. 7
DATË 18.10.2019
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË "SIRIUS" SHA

Sot, më datë 18.10.2019, ora 12:00, në vendin me adresë: Ruga "Ismail Qemali" Pallati nr. 18, Kati i II, Tiranë, u mbajt mbledhja e Aksionerit te Vetem, të shoqërisë "Sirius" sh a., regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K22826402D.

Në këtë mbledhje është i pranishëm aksionari i vetëm i shoqërisë "Sirius" Sh.a., Z. Koço Kokëdhima i cili zotëron 100% të aksioneve të kësaj shoqërie.

Kjo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve është thirrur për të diskutuar çështjet e përfshira në rendin e ditës, si më poshtë:

1. Miratimi i shitjes së 52000 (pesëdhjetë e dy mijë) aksioneve apo 8,40% (tetë presje katër) e kapitalit që shoqëria "SIRIUS" SHA zotëron në kapitalin e shoqërisë "F.K.APOLLONIA" SHA, me vlerë 52,000,000 (pesëdhjetë e dy milion) Lekë, në favor të Blerësit Z.Koço Kokëdhima;
2. Autorizimi i administratorit Faruk Bajraktari, që të përfaqësojë shoqërinë "SIRIUS" SHA në nënshkrimin e kontratës së shit-blerjes me Blerësin Z.Koço Kokëdhima;

Asambleja e Aksionarit te Vetem, pasi diskutoi çështjet e përfshira në rendin e ditës,

VENDOSI:

1. Të miratojë shitjen e 52000 (pesëdhjetë e dy mijë) aksioneve apo 8,40% (tetë presje katër) të kapitalit që shoqëria "SIRIUS" SHA zotëron në kapitalin e shoqërisë "F.K.APOLLONIA" SHA, me vlerë 52,000,000 (pesëdhjetë e dy milion) Lekë, në favor të Blerësit Z.Koço Kokëdhima;
2. Autorizimin e administratorit Faruk Bajraktari, që të përfaqësojë shoqërinë "SIRIUS" SHA në nënshkrimin e kontratës së shit-blerjes me Blerësin Z.Koço Kokëdhima;

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE TË SHOQËRISË "SIRIUS" SH.A
AKSIONARI I VETËM
KOÇO KOKËDHIMA

KONTRATË SHIT-BLERJE

(AKSIONE)

Sot, më datë 28 /10/2019, në Tiranë, midis palëve të mëposhtme lidhet kjo kontratë shit-bletje aksionesh me kushtet si vijon:

SHITËSI: Shoqëria “SIRIUS” SHA, regjistruar si person juridik me NUIS K22826402D, me adresë Rruga “Hasaf Dishnica”, Godina Akademia Sportive, pranë Stadiumit “Loni Papuçiu”, Kati II, Fier, përfaqësuar nga administratori Z. Faruk Bajraktari;

BLERËSI: **Koço KOKËDHIMA**, i biri i Theodhor, lindur në Qeparo, Vlorë, më 21/04/1959, dhe banues në adresën: Rr. Ismail Qemali, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.028976599 dhe nr.personal F90421072M;

Kushte të Përgjithshme

- A. Shoqëria “F.K.APOLLONIA” sha është një shoqëri aksionare regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: K23326401F.
- B. Sipas vendimit nr. 7 datë 18.10.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “SIRIUS” SHA u vendos: - Transferimi nëpërmjet shitblerjes i **52000 (pesëdhjetë e dy mijë)** aksioneve, që shoqëria “SIRIUS” SHA zotëron në shoqërinë “F.K.APOLLONIA” SHA, tek blerësi **Koço Kokëdhima**, kundrejt çmimit **52.000.000 (pesëdhjetë e dy milion)** Lekë.
- C. Shitësi dëshiron t’i shesë Blerësit, dhe Blerësi dëshiron të blejë 52 000 (pesëdhjetë e dy mijë) aksione që Shitësi zotëron në shoqëri, të cilat përfaqësojnë 8.4% (tetë pikë katër perqind) të kapitalit të shoqërisë “F.K.APOLLONIA” sha;
- D. Në përputhje me nenin 117 “Mënyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve” pika 1, shkronja b, të ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë hartohet kontrata e shitjes së aksioneve me kushtet si më poshtë vijon:

Neni 1
Objekti

Shitja dhe Blerja e Aksioneve

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit titullin e pronësisë të 52 000 (pesëdhjetë e dy mijë) aksioneve, të cilat përfaqësojnë 8.4% (tetë pikë katër perqind) të kapitalit të shoqërisë "F.K.APOLLONIA" sha. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet në fjalë ndjekin aksionet dhe kalojnë gjithashtu në pronësi të Blerësit.

Kalimi i Pronësisë së Ligjshme mbi Aksionet

- 1.2 Blerësi do të bëhet zotërues me të drejta të plota të aksioneve të blera në kapitalin e shoqërisë "F.K.APOLLONIA" sha, menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët.

Neni 2
Çmimi dhe Pagesa

- 2.1 Çmimi i shitjes që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për shitjen e aksioneve është **52.000.000 (pesëdhjetë e dy milion) Lekë**.
- 2.2 Ky çmim do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi në çdo mënyrë të lejuar nga ligjet në fuqi.

Neni 3
Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit

Shitësi deklaron dhe garanton se:

- 3.1 Shitësi është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i aksioneve që transferon tek Blerësi, dhe ka të drejtë të lidhë këtë kontratë shitblerje aksionesh si dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.
- 3.2 Shitësi garanton Blerësin nga çdo pretendim që të tretët mund të kenë në lidhje me aksionet, objekt i kësaj kontrate.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit

- 4.1 Blerësi garanton se ka të drejtë të lidhë këtë kontratë shitblerje të aksioneve dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.



Neni 5



Të ndryshme

- 5.1 Pavlefshmëria: Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast, do të zëvendësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkojë sa më shumë të jetë e mundur qëllimeve të palëve.
- 5.2 Ligji i zbatuar: Kjo Kontratë bazohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 5.3 Mosmarrëveshjet: Çdo mosmarrëveshje që mund dhe/ose rrjedh nga interpretimi, zbatimi, kryerja, shkelja ose përfundimi i kësaj Kontrate, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente.
- 5.4 Gjuha e kontratës: Kjo kontratë është hartuar në 3 kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

PALËT



SHITËSI

Shoqëria "SIRIUS" SHA
Përfaqësuar nga
Administratori
Faruk Bajraktari



Faruk Bajraktari

BLERËSI

Koço Kokëdhima



SHOQËRIA “2K GROUP”SHPK

NIPT: J82221005L

ADRESA E SELISË: RRUGA “ISMAIL QEMALI”,

PLL. ABISSNET, K.2, TIRANË

VENDIM NR.7

DATË 28/10/2019

**I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË “2K GROUP”SHPK**

Sot, më datë 28/10/2019, ora 10:00, në adresën: Rruga “Ismail Qemali”, Pallati “Abissnet”, Kati 2, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “2K Group”shpk, për të vendosur në lidhje me rendin e ditës si më poshtë vijon:

1. Miratimi i shitjes së 4200 (katër mijë e dyqind) aksioneve apo 0,68% (zero presje gjashtëdhjetë e tetë) e kapitalit që shoqëria “2K GROUP” SHPK zotëron në kapitalin e shoqërisë “F.K.APOLLONIA” SHA, me vlerë 4,200,000 (katër milion e dyqind mijë) Lekë, në favor të Blerësit Z.Koço Kokëdhima;
2. Autorizimi i administratores Znj. Brixhilda Kokëdhima, që të përfaqësojë shoqërinë “2K GROUP” SHPK në nënshkrimin e kontratës së shit-blerjes me Blerësin Z.Koço Kokëdhima;
3. Të ndryshme.

Në këtë mbledhje janë të pranishëm personalisht të gjithë ortakët e shoqërisë dhe konkretisht:

- Znj.Brixhilda Kokëdhima, e cila zotëron 35% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “2K Group”shpk;
- Z.Koço Kokëdhima, i cili zotëron 35% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “2K Group”shpk;
- Znj.Herjeta Deliaj, e cila zotëron 30% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “2K Group”shpk.

Meqënëse në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë ortakët e shoqërisë dhe kuorumi i nevojshëm për marrjen e vendimeve të vlefshme, Z.Koço Kokëdhima, në cilësinë e Kryetarit të mbledhjes, e deklaroi Asamblenë e Ortakëve të mbledhur rregullisht dhe të hapur. Pas

shqyrtimit me vëmendje të çështjeve të rendit të ditës, ortakët ranë dakord për sa më sipër në mënyrë unanime dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë,

VENDOSËN:

1. Të miratojnë shitjen e 4200 (katër mijë e dyqind) aksioneve apo 0,68% (zero presje gjashtëdhjetë e tetë) të kapitalit që shoqëria "2K GROUP" SHPK zotëron në kapitalin e shoqërisë "F.K.APOLLONIA" SHA, me vlerë 4,200,000 (katër milion e dyqind mijë) Lekë, në favor të Blerësit Z.Koço Kokëdhima.
2. Të autorizojnë administratoren Znj. Brixhilda Kokëdhima, që të përfaqësojë shoqërinë "2K GROUP" SHPK në nënshkrimin e kontratës së shit-blerjes me Blerësin Z.Koço Kokëdhima;

Pasi nuk pati çështje të tjera për të diskutuar, Kryetari i mbledhjes e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. **Koço KOKËDHIMA**

2. **Brixhilda KOKËDHIMA**

3. **Herjeta DELIAJ**



[Handwritten signatures and names of the board members: Koço Kokëdhima, Brixhilda Kokëdhima, and Herjeta Deliaj.]

KONTRATE SHITBLERJE
(AKSIONESH)

Sot, më datë 11 /11/2019, në Tiranë, midis palëve të mëposhtëme lidhet kjo kontratë shit-blerje aksionesh me kushtet si vijon:

SHITËSI: Shoqëria “**2K GROUP**” SHPK, regjistruar si person juridik me NUIS J82221005L, me adresë Rruga “Ismail Qemali”, Pallati Abissnet, Kati II, Tiranë, përfaqësuar nga administratorja Znj. Brixhilda Kokëdhima;

BLERËSI: **Koço KOKËDHIMA**, i biri i Theodor, lindur në Qeparo, Vlorë, më 21/04/1959, dhe banues në adresën: Rr. Ismail Qemali, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.028976599 dhe nr.personal F90421072M;

Kushte të Përgjithshme

- A. Shoqëria “F.K.APOLLONIA” sha është një shoqëri aksionare regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: K23326401F.
- B. Sipas vendimit nr. 7 datë 28.10.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “2K GROUP” SHPK u vendos: - Transferimi nëpërmjet shitblerjes i **4200** (katërmijë e dyqind) aksioneve, që shoqëria “2K GROUP” SHPK zotëron në shoqërinë “F.K.APOLLONIA” SHA, tek **Koço Kokëdhima**, kundrejt çmimit **4.200.000** (katër milion e dyqind mijë) Lekë.
- C. Shitësi dëshiron t’i shesë Blerësit, dhe Blerësi dëshiron të blejë 4200 (katër mijë e dyqind) aksione që Shitësi zotëron në shoqëri, të cilat përfaqësojnë 0,68 (zero presje gjashtëdhjetë e tetë) të kapitalit të shoqërisë “F.K.APOLLONIA” sha;
- D. Në përputhje me nenin 117 “Mënyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve” pika 1, shkronja b, të ligjit nr.9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë hartohet kontrata e shitjes së aksionëve me kushtet si më poshtë vijon:



Neni 1

Objekti

Shtija dhe Blerja e Aksioneve

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit titullin e pronësisë të 4.200 (katërmijë e dyqind) aksioneve, të cilat përfaqësojnë 0.68% (zero pikë gjashtëdhjetë e tetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "F.K.APOLLONIA" sha. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet në fjalë ndjekin aksionet dhe kalojnë gjithashtu në pronësi të Blerësit.

Kalimi i Pronësisë së Ligjshme mbi Aksionet

- 1.2 Blerësi do të bëhet zotëruar me të drejta të plota të aksioneve të blera në kapitalin e shoqërisë "F.K.APOLLONIA" sha, menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate nga të dyja palët.

Neni 2

Çmimi dhe Pagesa

- 2.1 Çmimi i shitjes që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për shitjen e aksioneve është **4.200.000 (katër milion e dyqind mijë) Lekë.**
- 2.2 Ky çmim do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi në çdo mënyrë të lejuar nga ligjet në fuqi (bankë, kompensim detyrimesh etj).

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit

Shitësi deklaron dhe garanton se:

- 3.1 Shitësi është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i aksioneve që transferon tek Blerësi, dhe ka të drejtë të lidhë këtë kontratë shitblerje aksionesh si dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.
- 3.2 Shitësi garanton Blerësin nga çdo pretendim që të tretët mund të kenë në lidhje me aksionet, objekt i kësaj kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit

- 4.1 Blerësi garanton se ka të drejtë të lidhë këtë kontratë shitblerje të aksioneve dhe të përmbushë detyrimet që rrjedhin prej saj.



Neni 5
Të ndryshme

- 5.1 Pavlefshmëria: Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast, do të zëvendësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkojë sa më shumë të jetë e mundur qëllimeve të palëve.
- 5.2 Ligji i zbatuar: Kjo Kontratë bazohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 5.3 Mosmarrëveshjet: Çdo mosmarrëveshje që mund dhe/ose rrjedh nga interpretimi, zbatimi, kryerja, shkelja ose përfundimi i kësaj Kontrate, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente.
- 5.4 Gjuha e kontratës: Kjo kontratë është hartuar në 2 kopje origjinale në gjuhën Shqipe.




SHITËSI

Shoqëria "2K GROUP" SHPK

Përfaqësuar nga

Administratori

Brixhilda KOKËDHIMA

BLERËSI

Koço KOKËDHIMA

